

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 16, datë 8.7.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 23.12.2014, “PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR SHËRBIMET E
RADIOKOMUNIKACIONIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i financave dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP),

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Financave dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) nr. 30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit”, të ndryshuar, në pikën 6, fjalia e parë ndryshon me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“Për shërbimin e kryer, AKEP-i mban 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave, që ka arkëtuar dhe deklaron dhe paguan në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar 90% të shumës së arkëtuar.”

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES
TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Gentian Sala